

Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” Shijak



Lënda: Gjuha shqipe

Klasa 2

Tema mësimore:

Unë kam,ti ke (ora e II)

Situata e të nxënit:


Përdorimi i foljes kam në
fjali në kohën e tashme
në situata të ndryshme .

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës dhe temës mësimore

Nxënësi/ja:

- **-Zgjedhon** saktë foljen *kam* në të gjitha vetat e kohës së tashme;
- **-Përshtat** foljen me përemrin vetor përkatës në fjali;
- **-Zëvendëson** emrat e njerëzve/sendeve me përemrat e duhur (Ai, Ajo, Ata, Ato);
- **-Dallon** kuptimin e foljes *jam* (identitet) nga folja *kam* (zotërim).

Kujtojmë së bashku : Cfarë është folja ?



-Kemi mësuar që folja **Kam** përdoret e pavarur në fjali, në këtë rast ajo tregon cfarë ke ti, zotërim të një sendi objekti etj.

-Ka raste kur ajo përdoret e shoqëruar me një folje tjetër nga pas

-Këtu kemi thënë që ajo ka rolin e foljes ndihmëse

-Sot do ta shohim përsëri foljen kam si folje e cila tregon zotërim

Folja **kam** ndryshon formën e saj sipas vetave

Rikujtojmë së bashku zgjedhimin e foljes kam

Numri Njëjës

- Veta e parë: Unë kam
- Veta e dytë: Ti ke
- Veta e tretë: Ai / Ajo ka

Numri Shumës

- Veta e parë: Ne kemi
- Veta e dytë: Ju keni
- Veta e tretë: Ata / Ato kanë

Ti Ai/ajo Ne Ju Unë Ata/ato

1. Shkruaj për emrat: unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato në vendin e duhur.

ke një lepur të butë.

ka një gëzof të bukur.

keni një shtëpi prej druri në mal.

kam një bluzë të trashë.

kemi një shtëpi të madhe në fshat.

kanë një fermë të madhe

Ush.2. Vendos foljen kam ashtu si duhet në fjalitë e mëposhtme:

Ka kishte kam ke keni kanë

Ai një lepur. Ata peshq
të kuq. Ju një qen të madh. Ti
..... një miush të bardhë. Ne
pëllumba. Unë një gjel dhe disa pula.

Ush.3 Në fjalitë e mëposhtme zëvendëso emrat në kllapa me: ai,
ajo, ata

ai **ajo** **ato** **ata**

(Linda) është piktores. (Astriti) është notar. (Vajzat)
kanë penelë dhe bojëra uji. (Djemtë) kanë syze noti.

Ush.4 Vendos përemrin vetor para foljes.

Unë Ti Ne Ju Ata/ato Ai/ajo

..... ke ditëlindjen.

..... ka mbledhje.

..... kam stërvitje.

..... keni festë.

..... kemi shfaqje.

..... kanë takim.

5. Shkruaj si duhet foljet në kllapa.

kemi

kanë

kam

ka

keni

ke

Unë (kemi) kukull që flet, ndërsa ti (ka) makinë me bateri.

Ne (keni) kompletin e kukullës Barbi.

Ju (kanë) lodra elektronike

Ata (ka) tullumbace me ngjyra

Ana (ka) shumë vazo me lule.

Ne të gjithë (kanë) gjëra shumë të bukura.

5. Shkruaj si duhet foljet në kllapa.

kemi

kanë

kam

ka

keni

ke

Unë (kemi) kukull që flet, ndërsa ti (ka) makinë me bateri.

Ne (keni) kompletin e kukullës Barbi.

Ju (kanë) lodra elektronike

Ata (ka) tullumbace me ngjyra

Ana (ka) shumë vazo me lule.

Ne të gjithë (kanë) gjëra shumë të bukura.



1920 x 1080 163.9 KB



57%



LIVEWORKSHEETS

Punë në grupe

Grupi 1: Zgjidhni 3 kafshë (p.sh. Lepuri, Luani, Zogu). **Do të plotësoni sipas shembullit** (p.sh. Lepuri ka veshë të gjatë).

Grupi 2: Me këto fjalë (Mjeku, Piktoria, Notari) do të formoni fjali

- **Shkrimi:** Nxënësit duhet të plotësojnë fjalinë: "Ata kanë..." (p.sh. Piktoret kanë penela).
- **Sfida:** Të gjejnë sa më shumë sende.

Grupi 3: Shikoni rreth e rrotull klasës dhe formoni fjali për veten dhe shokët: Psh "Ju **keni** fletore mbi bankë".

Grupi 4: Do tu jap 4 fjali me gabime (p.sh. *Unë kemi top*). Ju duhet ti korrigjoni.

Detyra shtëpie: Zgjidh 3 rreshta nga ushtrimi 6 dhe formo fjali të plota në fletore (p.sh. *Ti je mjek dhe ti ke stetoskop*).